



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA E APELIT PRISHTINË**

---

Numri i lëndës: 2019:095061

Datë: 12.12.2024

Numri i dokumentit: 06592330

PAKR.nr.488/2024

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Bashkim Hyseni - kryetar, Afërdita Bytyçi dhe Zyhdi Haziri - anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorës profesionale Fitore Batatina, në çështjen penale kundër të akuzuarve V.M, Sh.G dhe A.G për shkak të veprës penale në bashkëkryerje, Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 273 par. 2, lidhur me nenin 281 par. 1 pika 1.1 e 1.9, e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të akuzuarit V.M, edhe për veprën penale, Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, duke vendosur në lidhje me ankesën e Prokurorisë Themelore – Departamenti për Krime të Rënda në Pejë, dhe ankesën e mbrojtësit të akuzuarit, V.M, av. Vehbi Beqiri, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr. 41/23, i datës 28.05.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur konform nenit 390 të KPPK-së, më datë 29.10.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHEN si të pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore – Departamenti për Krime të Rënda në Pejë, dhe ankesa e mbrojtësit të akuzuarit V.M, av. Vehbi Beqiri, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr. 41/23, i datë 28.05.2024, VËRTETOHET.

## A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin, PKR.nr. 41/23, të datës 28.05.2024, të akuzuarin V.M e ka shpallur fajtor për veprën penale, *Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 273 par.1 të KPRK-së, dhe veprën penale, Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, dhe e ka gjykuar si në vijim:*

Në aplikim të nenit 80 par.1 të KPRK-së, i ka përcaktuar:

Për veprën penale të përshkruar në pikën I. të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar, Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 273 par.1 të KPRK-së, *dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 vit burgim dhe dënim me gjobë në shumë prej 20.000,00 (njëzet mijë) Euro.*

Për veprën penale të përshkruar në pikën II. të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, *dënim me gjobë në shumë prej 1000 (një mijë) Euro.*

Në aplikim të dispozitave ligjore të Kodit Penal të Kosovës dhe Kodit të Procedurës Penal të Kosovës, e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 viti, duke i llogaritur kohën e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak nga data 13.07.2017, deri me datë 30.03.2018, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, dhe dënim unik me gjobë në shumë prej 21.000,00 (njëzet e një mijë) euro, të cilën gjobë është obliguar ta paguajë në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcenim të përmbarimit me dhunë.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata mund të zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim. Kur dënimi me burgim zëvendësohet me dënimin me gjobë, një ditë burgim llogaritet me njëzet (20) Euro gjobë. Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën në tërësi, gjykata do ta zëvendësojë pjesën e mbetur të gjobës me dënim me burgim. Nëse personi i dënuar e paguan pjesën e mbetur të gjobës, ekzekutimi i dënimit ndërpritet.

I akuzuari është obliguar që në emër të shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, të paguaj shumën prej dyqind (200) €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, si dhe është obliguar që në emër të Programit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, të paguaj shumën prej pesëdhjetë (50) €, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konform nenit 273 par.5 dhe nenit 374 par.3 të KPRK-së, gjykata ka konfiskuar: 10 paketime me m.... në peshë prej 8.606 gram, një pistolette e markës C... Z... M.. të kalibrit 7.62x25mm, me numër serik C-....., prodhim jugosllav, me një karikator dhe pesë copë fishek, dhe ka urdheruar që 10 paketime me m... në peshë prej 8.606 gram, një pistolette e markës C.Z M të kalibrit 7.62x25mm, me numër serik C-....., prodhim jugosllav, me një karikator dhe pesë copë fishek, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit të shkatërrohet.

Në pajtim me nenin 271 të KPPRK-së, gjykata ka urdheruar konfiskimin e parave në vlerë prej 2.115 Euro, të sekuestruara sipas urdhrit përfundimtar nën shenjën PPr.nr. 59/17 dt. 17.07.2017.

Në pajtim me nenin 113 të KPPRK-së gjykata ka urdheruar kthimin e veturës “J...”, ngjyrë b.. e errët me targa të regjistrimit xxx me numër të shasisë Sxxxx, me leje të qarkullimit Txxxx, në emër të B. A.N, banues në Tirane, Rr. Minerpeza P.210-3-19, të konfiskuar nga R.M, baba i të akuzuarit V.M, i sekuestruar sipas Urdhrit të Gj. Themelore në Mitrovicë, PPr.Nr.59/2017 i datës 25.08.2017, dhe Aktvendim për masën e përkohshme për sigurimin e pasurisë PPr.nr.59/17 të datës 07.11.2017.

Është obliguar Agjencia për Sekuestrimin e Pasurisë së Konfiskuar në Prishtinë, që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi t`ia dorëzojë të akuzuarit - pasurinë e lartpërmendur si në pikën IV d) përkatësisht të bëjë kthimin e mjeteve dhe pasurive, meqenëse PTHK-Pejë, ka kërkuar kthimin – pra nuk ka bazë për konfiskimin e tyre.

Është obliguar Agjencia për Sekuestrimin e Pasurisë së Konfiskuar në Prishtinë, që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi t`i marr nën administrim dhe menaxhim sendet e konfiskuara përkatësisht paratë dhe pasuritë si në pikën III. c) ashtu që Agjencia ka të drejtë që të administrojë me të njëjtat në përputhje me Ligjin mbi Agjencinë.

Gjykata duke vepruar në pajtim me nenin 364 të KPPRK-së, të akuzuarit Sh.Gdhe A.G, i ka liruar nga akuza, se në bashkëkryerje me E.SH kishin për të kryer veprën penale, Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose

analoge nga neni 273 par.2 lidhur me nenin 281 par.1, pika 1.1 e 1.9 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, pasi që nuk është provuar se të njëjtit kanë kryer veprën penale.

Gjykata ka urdhëruar kthimin e veturës Golf 2, me targa të regjistrimit xx-x-xx, markës VW tipi xxE me numër të shasisë W....., prodhimi i vitit 1990, me pronar V.K, i sekuestruar sipas urdhrorit për sekuestrim të përkohshëm i datës 17.07.2017, nën shenjën PPr. Nr.59/17 në raport me të akuzuarin A.G, si dhe ka urdhëruar kthimin e veturës së markës VW xxx me targa të regjistrimit xx, me numër të shasisë Wxxx, i sekuestruar me urdhër për sekuestrim të përkohshëm i datës 17.07.2017 PPr.59/17, në emër të M. G, pronarë i Rent A Car.

Është obliguar Agjencia për Sekuestrimin e Pasurisë së Konfiskuar në Prishtinë, që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi t`ia dorëzojë të akuzuarit - pasurinë e lartpërmendur si në pikën A) dhe B), përkatësisht të bëjë kthimin e mjeteve dhe pasurive, meqenëse PTH-Pejë, ka kërkuar kthimin e veturës si në pikën A) derisa kthimi i veturës si në pikën B) - nuk ka bazë për konfiskim.

Në kuptim të nenit 453 par.1 të KPPRK-së, shpenzimet procedurale kanë rënë në buxhet të Gjykatës.

Gjykata Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, me aktvendimin, PKR.nr.41/23, të dates 18.06.2024, ka përmiresuar aktgjykimin me shenjën, PKR.nr. 41/23, të datës 28.05.2024, në pjesën e dispozitivit, përkatësisht pas fjalës ku është shënuar “pika II në raport me të akuzuarin V.M”, duhet të shtohet, citat: “me datë 13.07.2017, rreth ores 19:56, në shkelje të ligjit të zbatueshëm mbi armët ka poseduar pistoletën e markës “C.Z”, M., të kalibrit 7.62X25 mm, me numer serik C-....., prodhim jugosllav, me një karikator dhe pesë (5) copë fishek të cilat janë gjetur dhe konfiskuar nga policia”.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë kanë ushtruar:

- Prokuroria Themelore – Departamenti për Krime të Rënda në Pejë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që Gjykata Apelit, të aprovoj ankesën e prokurorisë si të bazuar, dhe aktgjykimin e ankimuar t`a ndryshojë ashtu që të akuzuarit Sh.G, V.M dhe A.G të shpallën fajtor dhe të dënohen për veprën penale, Blerja, posedimi, shpërndarja apo shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope apo analoge, nga neni 273 par.2, lidhur me nenin 281 par.1, nënpar. 1.1 dhe 1.9 e lidhur me nenin

31 të KPRK-së, ose aktgjykimi në fjalë të anulohet dhe çështja t'i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe rivendosje, ose të akuzuarit V.M t'i shqiptohet dënim më i ashpër me burgim me të cilin dënim do të arrihet në tërësi qëllimi i ndëshkimit.

- Mbrojtësi i të akuzuarit V.M, av. Vehbi Beqiri, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së dispozitave të Kodit Penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, vendimit lidhur me dënimin dhe vendimit mbi konfiskimin e të hollave, me propozim që Gjykata e Apelit, këtë ankesë t'a aprovoj si të bazuar, aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë t'a ndryshoj ashtu që të akuzuarin V.M, t'a liroj nga akuza, ose aktgjykimin në fjalë t'a anulojë dhe çështjen t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje, apo në rastin më të pafavorshëm dënimin e shqiptuar t'a zvogëloj.

Prokurori i Apelit më parashtrësën, PPA/I.nr.449/2024, datë 20.08.2024, ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore në Pejë, e ushtruar kundër aktgjyimit të Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.41/23, datë 28.05.2024, të aprovohet, ashtu që aktgjykimi i ankimuar të ndryshojë dhe të akuzuarit Sh.G, V.M dhe A.G, të shpallën fajtor për veprën penale për të cilën janë akuzuar dhe t'iu shqiptohen dënime më burgim ose aktgjykimin i ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje, ndërsa, ankesa e mbrojtësit të akuzuarit V.M, av. Vehbi Beqiri, të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata e Apelit caktoj dhe mbajti seancën e kolegjit në pajtim me dispozitën e nenit 390 të KPPRK-së, në të cilën morën pjesë: i akuzuari Sh.G, i akuzuari V.M dhe mbrojtësi i tij av. Vehbi Beqiri, mbrojtësi i të akuzuarit A.G, av. Mahmut Halimi, ndërsa nuk prezantuan Prokurori i Prokurorisë së Apelit, mbrojtësja e të akuzuarit Sh.G, av. Fatmire Braha, si dhe i akuzuari A.G, edhe pse të njoftuar në mënyrë të rregullt për kohën dhe vendin e mbajtjes se seancës se kolegjit, andaj, seanca e kolegjit u mbajt konform nenit 390 par. 4 të KPPK-së, në mungesë të tyre. Në seancë mbrojtësi i të akuzuarit V.M av. Vehbi Beqiri, pasi që elaboroi pretendimet e bëra në ankesë mbeti pranë propozimit të bërë në ankesë. I akuzuari V.M deklaroi se e përkrahë mbrojtësin e tij. I akuzuari Sh.G propozoi që ankesa e Prokurorit të refuzohet si e pabazuar. Avokati, Mahmut Halimi propozoi që ankesa e Prokurorit të refuzohet si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar sa i përket të mbrojturit të tij, A.G, të vërtetohet.

Gjykata e Apelit pasi që ka studiuar aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, ankesën e mbrojtësit të akuzuarit V.M, av. Vehbi Beqiri, propozimin e Prokurorisë së Apelit, dhe duke analizuar shkresat

e lëndës në këtë çështje penale në vështrim të nenit 394 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale, gjeti se:

*Ankesat nuk janë të bazuara.*

*Pretendimet ankimore të Prokurorisë*

Në ankesë prokurori pretendon se gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë jo të plotë dhe në mënyrë të gabuar, çka ka ndikuar që aktgjykimi në fjalë të jetë i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 2 të KPPK-së, dhe si pasojë e kësaj është shkelur edhe ligji penal në dobi të akuzuarve. Gjykata ka shkel dispoziten e nenit 384 par.2.7 të KPPK-së, ngase aktgjykimi nuk është hartuar në pajtim me nenin 369 par.7 të KPPK-së. Po ashtu, gjykata ka deshtuar të sqaroje se pse ne rastin konkret kemi të bejmë me vepër penale nga neni 273 par. 1 e jo nga neni 273 par. 2 të KPRK-së, pasi që të akuzuarit ditën kritike, janë zënë në veturën e përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, duke transportuar substancën narkotike, e jo siç ka potencuar gabimisht gjykata, se i pandehuri V.M ditën kritike "ka poseduar me qëllim të shitjes". Gjykata ka deshtuar që të jap arsyetim për faktet vendimtare të këtij rasti, për arsye se arsyetimi i gjykatës është në kundërshtim me vetveten si dhe me dispozitivin e aktgjykimit sa i përket fakteve vendimtare të çështjes, ku nga gjykata nuk është arritur të sqarohet në mënyrë të qartë se cilat kanë qenë ato fakte të cilat e kanë dërguar në konkludim se të akuzuarit Sh.. dhe A.. nuk është provuar se kanë kryer veprën penale për të cilën janë akuzuar.

Se në rastin konkret shkelja është bërë edhe kur gjykata të akuzuarit V.M i ka shqiptuar denimin me burgim në kohezgjatje prej një viti, pasi që minimumi i denimit me burgim për këtë veprën penale është dy vite, pra gjykata të njëjtit i ka shqiptuar denimin nën minimumin ligjor.

Lidhur me shkelje të ligjit penal prokurori në ankesë ka theksuar se nga vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike, gjykata e shkallës së parë duke marrë aktgjykim lirues ndaj të akuzuarve të lartcekur, por edhe në raport me të akuzuarin V.. i cili është shpallur fajtor për veprën penale Blerja, posedimi shpërndarja apo shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope apo analoge nga neni 273 par. 1 të KPRK-së, ka shkelur edhe ligjin penal në favor të akuzuarve, e si pasojë e shkeljeve të lartcekura dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, e posaçërisht duke mos dhënë arsye bindëse se në cilat prova e ka mbështetur pjesën liruese të aktgjykimit.

Konsideron se me provat e administruar në shqyrtim gjyqësor është vërtetuar përtej dyshimit mirë të bazuar së të akuzuarit: V.Sh dhe A.. e kanë kryer veprën penale për të cilën janë akuzuar, pasi që edhe në veprimet e të akuzuarve Sh. dhe A.. formësohen të gjitha elementet e figurës së kësaj vepre penale, e të cilat kushtëzojnë kualifikimin juridik të veprës penale nga neni 273 duke e ndërlidhur të njëjtën me dispozitën e nenit 281 par. 1, nënpar. 1.1 të KPRK-së, pasi që të njëjtit kanë vepruar si anëtar të grupit.

Gjykata në këtë rast ka refuzuar edhe kualifikimin juridik nga dispozita e nenit 273 e lidhur me nenin 281 par. 1, nën par. 1.9 të KPRK-së, duke e arsyetuar me faktin së në rastin konkret sasia e gjetur e substancës narkotike prej 8606 gram (tetë kilogram dhe gjashtëqindgjashtë gram) "nuk mund të konsiderohet sasi e madhe e narkotikut, duke u bazuar në praktiken e shumë rasteve me aktgjykime të formës së prere". Gjykata në rastin konkret edhe pse është thirrur në praktiken gjyqësore për ta përcaktuar së a kemi të bëjmë me "sasinë e madhe të narkotikut", fillimisht ka shkelur ligjin penal pasi që praktika gjyqësore në sistemin tone juridik nuk është burim i së drejtës, e po ashtu nuk ka potencuar asnjë kriter tjetër sipas të cilit mund të vihet në përfundim se cila është ajo sasi e narkotikut e cila mund të konsiderohet sasi e madhe të narkotikëve, substancave psikotrope ose substancave analoge. Në rastin konkret, e pasi që tek të akuzuarit ditën kritike është gjetur dhe sekuestruar substanca narkotike e llojit Marihuanë (kanabis) në sasi prej 8606 gram (tetë kilogram dhe gjashtëqindgjashtë gram), e pas parasysh faktin notor, të konfirmuar edhe me studime të shumta shkencore, së për ta konsumuar këtë lloj të narkotikut dhe për ta "shijuar efektin" e tij mjafton një "dozë" prej 0.5 gram, jemi të bindur së në këtë rast kemi të bëjmë me një sasi jashtëzakonisht të madhe të substancës narkotike, e cila, po të shpërndahej, do të kishte ndikuar negativisht në jetën e mijëra njerëz.

Përfundimisht, sipas këndvështrimit të prokurorisë, gjykata në rastin konkret ka shkelur ligjin penal edhe me rastin e ri cilësimit të veprës penale nga dispozita e nenit 273 par. 2 në paragrafin 1 të Kodit Penal, pasi që gjykata të akuzuarin V.M e ka shpallur fajtor për veprimin inkriminues së "ditën kritike pa autorizim ka poseduar substancën narkotike me qëllim të shitjes...", i cili veprim bie në kuadër të dispozitës së nenit 273 par. 1 të KPRK-së. Në anën tjetër, Prokuroria të njëjtit i ka akuzuar së ditën kritike "kanë transportuar substancën narkotike me qëllim të shitjes..."

Prokurori në ankesë ka cituar provat e administruara nga gjykata shkallës së parë në shqyrtim gjyqësor, duke pretenduar se është vërtetuar se të akuzuarit kanë kryer veprën penale për të cilën janë akuzuar.

Sa i përket vendimit mbi dënimin në raport me të akuzuarin V.M prokurori në ankesë ka thekësuar se gjykata ka bërë shkelje kur të akuzuarit i ka zbutur dënimin me burgim nën minimumin e paraparë ligjor për këtë veprë penale, pasi që nuk kanë ekzistuar rrethana të cilat kishin me arsyetuar zbutjen e dënimit. Konsideron së në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka mbivlerësuar rrethanat lehtësuese dhe nuk e ka bërë matjen e dënimit në mënyre të duhur, pasi që në rastin konkret mbizotërojnë rrethanat rënduese edhe në aspektin kuantitativ por edhe në atë kualitativ, se është dashtë që të njëjtit ti shqiptohet një dënim më i ashpër me burgim, se dënimi i shqiptuar të akuzuarit V... jo vetëm që nuk është në proporcion me peshën e veprës së kryer penale, me rrezikshmërinë shoqërore të kësaj veprë, me objektin e mbrojtur e që është shëndeti i njerëzve, por ky dënim nuk do të arrin as qëllimet e ndëshkimit dhe efektin e një dënimi meritor, si dhe nuk do të shërben si preventivë për sigurinë e përgjithshme, ky dënim i cili nuk i përgjigjet as shkalles e as peshës së veprës penale të kryer nga ana e të njëjtit, do të ndikon negativisht në opinionin dhe nuk do të ketë rolin e preventimit për kryesit tjerë potencial të veprave penale në të ardhmen. Andaj, nga e cekura Gjykatës së Apelit i propozon si më lartë.

*Pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit V.M, av.Vehbi Beqiri*

Në ankesë mbrojtësi pretendon se aktgjykimi i ankimuar është nxjerrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe atë nga neni 369, dhe 384 të KPPK-së, se me aktgjykimin në fjalë gjykata nuk ka arsyetuar faktet dhe rrethanat që përbëjnë figurën e veprës penale. Si tërësi arsyetimit të aktgjykimin të ankimuar i mungojnë arsyet për faktet vendimtare dhe ato që janë dhënë janë në kundërshtim të plotë me provat dhe shkresat e lëndës. Gjykata, nuk i ka përmbushur obligimet nga neni 3, 7, 8, 48, 101 dhe 257 të KPPK-së, e as obligimet nga Konventa Evropiane për të drejtat e njeriut (neni 6) dhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës (neni 31), ngase ndaj V.M, përkundër faktit që asnjë provë materiale apo dëshmitar nuk ishte për të dëshmuar pohimin si në aktakuzë dhe se i njëjti ishte viktimë e rastit, gjykata e ka shpallur fajtor dhe dënuar, duke mos i vlerësuar faktet që ishin në favor të akuzuarit. Se faktet kryesore në drejtim të veprës penale për të cilën është akuzuar V.M, nuk e dëshmojnë përtej dyshimit të bazuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, kjo e bënë këtë aktgjykim të pabazuar dhe kundërthënës me dëshmitë dhe provat materiale. I akuzuari është shpallur fajtor edhe pse asnjë dëshmitar nuk e përmend e as provë materiale e administruar në gjykatë, por gjykata e shpallë fajtor në bazë të një kundërthënies në deklarinimin e tij sa i përket një çante e cila tani për tani ishte e paidentifikuar se a kemi të bëjmë me çantën e njëjtë që është gjetur ditën kritike në bagazhin e veturës ku ishte bashkëudhëtar.



Lidhur me veprën penale, Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim dhe shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, mbrojtësi thekson se sipas nenit 3 të KPRK-së, konkretisht neni 3 par. 2, zbatimi i ligjit më të favorshëm, pika 2 ku thuhet se: “Në rast se ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë, atëherë ndaj kryesit zbatohet ligji që është më i favorshëm”, e që sipas mbrojtjes në rastin konkret duhet të zbatohet ligji më i favorshëm.

Lidhur me vendimin mbi dënim mbrojtësi ka theksuar se dënimi i shqiptuar është shumë i lartë si ai me burg, e veçanërisht ai me gjobë, dënim i cili nuk është aspak praktikë e aplikuar në Kosovë, e që shuma prej 21.000,00 €, është një dënim tejet i ashpër, e që padyshim që do të ndikojë në mirëqenien ekonomike tek i akuzuari dhe familja e tij. Ka shtuar se edhe vendimi mbi konfiskimin e mjeteve në vlerë prej 2115 €, të gjetur në ditën kritike tek i akuzuari i cili kishte me vete nga se ishte në përfundim të punës, ka theksuar se këto mjete janë pjesë e punës në ordinancën private ku punonte, por gjykata pa asnjë bazë të njëjtat i ka konfiskuar, pa i vlerësuar fare rrethanat se si bazohet ky vlerësim kur me asnjë provë nuk janë vërtetuar se janë pasuri e fituar me vepër penale. Nga të cekurat mbrojtja ka propozuar si më lartë.

#### *Vlerësimi i Gjykatës së Apelit*

#### *Të gjeturat për pretendimet ankimore për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale*

Kolegji Penal i Gjykatës së Apelit, gjen të pa bazuara pretendimet ankimore të prokurorisë dhe mbrojtësit të akuzuarit V.M, av. Vehbi Beqiri, se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.2, nënpar. 2.7 e lidhur me nenin 369 par.7 të KPPK-së, se gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykitimit, në mungesë të provave, nuk ka arritur t’ a sqaroj në mënyrë të qartë dhe të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsye i konsideron si të vërtetuara, se gjykata nuk arsyeton në mënyrë bindëse dhe të drejtë faktin, se cilat ishin provat vendimtare kur të akuzuarin V.M e shpalli fajtor dhe të akuzuarit Sh.G e A.G, i liroj nga akuza.

Kolegji vlerëson se pretendimet lartë cekura ankimore, për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nuk qëndrojnë e as që ka shkelje tjera të dispozitave të procedurës penale, për të cilat, sipas detyrës zyrtare kujdeset kjo Gjykatë, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e aktgjykitimit të ankimuar. Aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale në të cilat thirret mbrojtësi i të akuzuarit në ankesën e ushtruar e as shkelje në të cilat thirret prokuroria, ngase dispozitivi i aktgjykitimit është i qartë, i kuptueshëm dhe

konkret, në përputhshmëri të plotë edhe me arsyetimin dhe përpilimin e dispozitivit. Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, janë dhënë arsyet e duhura mbi të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështje penale-juridike, duke vepruar konform dispozitave të nenit 369 par.6 dhe 7 të KPPK-së, gjykata e shkallës së parë, ka paraqitur arsyet për çdo pikë të aktgjykimit dhe atë si ato faktike dhe ato juridike, të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo Gjykatë.

Gjykata e shkallës së parë, vlerësimin e provave e ka bërë në pajtim me dispozitat e nenit 361 par.1 të KPPK-së, duke dhënë arsye të qarta dhe konkrete për vendin, kohën dhe mënyrën se si ka ardhur deri të kryerja e veprave penale nga i akuzuari V.M, për të cilat vepra penale i akuzuari është shpallur fajtor dhe gjykuar si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Po ashtu gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të qarta dhe konkrete se si ka ardhur deri të përfundimi për ti liruar nga akuza të akuzuarit Sh.G dhe A.G. Gjykata e shkallës së parë ka bërë analizën e të gjitha provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me to ka paraqitur përfundimet e veta, të cilat si të drejta objektive, dhe të ligjshme, i aprovon edhe kjo Gjykatë, prandaj thënie ankimore se kemi të bëjmë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale konstatohen të paqëndrueshme.

#### *Të gjeturat lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike*

Sa i përket pretendimeve ankimore përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, kolegji penal i Gjykatës se Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë gjendjen faktike në këtë çështje penale e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, për shkak se me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se i akuzuari V.M ka kryer veprat penale për të cilat është shpallur fajtor.

Deri të vërtetimi i gjendjes faktike, gjykata e shkallës së parë ka ardhur pas administrimit të provave dhe atë: Raporti i ekspertizës e AKF-së me nr. të referencës AKF/2017 – 2483/2017-2239 dt. 31.10.2017, Raporti i ekspertizës me nr. referencës AKF/2017-2483/2017 – 2238 dt. 25.09.2017, Raporti i ekspertizës me nr. referues AKF/2017-2483/2017-2240 dt. 05.10.2017, Raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes dt. 13.07.2017, Raporti i sistemit për menaxhimin e kufirit, Raporti legal i IPKO-së për nr. e telefonit 38649181637 që ka të bëjë me numrin e telefonit të Sh.. Gecaj, Informacioni i zyrës për veprim sipas kërkesës ligjore ZKL.nr. 2733/2017 dt. 05.12.2017, Lista e gjerave të konfiskuara prej Rizah Malaj dt. 14.08.2017, Vërtetimi mbi marrjen e sendeve nga A.Gdt. 09.08.2017, Foto albumi i që ka të bëjë me Drejtorinë e Teknikes kriminalistike të cilat janë të nxjerra nga kamerat e sigurisë së qyteti hyrje të Mitrovicës, kamerat

e GJTH Mitrovicë, kamerat e qytetit të Mitrovicës të vendosura në rrugën “Dëshmorët e Kombit”, kamerat e vendosura në udhëkryqin “Shemsi Ahmeti” dhe “Beslim Bajgora”, objektit DR Mitrovicë e Jugut rr. “Beslim Bajgora”, kamerat e vendosur në zyrën e administrative lagja e boshnjakëve rr. “Osllobgjenja” dhe “Milosh”, CD-të që ka të bëjë me qartësimin e imazheve dhe raporti njoftues nr. IRKIDHI89/17/VP dt. 27.09.2017.

Kolegji gjen se më të drejtë gjykata shkallës së parë nuk i ka fal besimin mbrojtjes se te akuzuarit V.M i cili ka mohuar kryerjen e veprës penale si në pikën I. të aktakuzës, duke u mbrojtur se nuk ishte në dijeni se çka ka pas në çantë të cilën ka thenë se e ka vendosur shoku i tij i ashtuquajtur E.Sh, fillimisht në veturën “Jaguar” e më pas në veturën “GolfIV”, përkatësisht në bazë të mbrojtjes së tij ka deklaruar se personin me emrin E... e kishte shok që nga studimet dhe kishte vazhduar shoqërinë me të njëjtin, rrethanë e vërtetuar edhe në bazë të kontakteve telefonike, me të cilin ditën kritike, ishte takuar në kafiterinë “Time Caffè” ish kafiteria “Te Oki”, siç edhe është vërejtur në pamjet e kamerave të tërhequra nga objekti “Rrukolli” në Skenderaj, pra se të lokali “Te Oki”, përkatësisht kamera 1, pamje të datës 13.07.2017, nga ora 18:55:00 deri 19:08:00, derisa nga kamera nr. 8 vërehet se në orën 18: 55:20 në atë lokal vjen i akuzuari V.M së bashku me personin E.Sh. Sipas të akuzuarit V..., arsyeja ishte të pinë kafe së bashku, por me kërkesë të shokut të tij E..., kanë vendosur të shkojnë në Mitrovicë për të drekuar, andaj dhe i ka thënë E..., se po e thërret një shok për ta marr me veti, fjala ishte për të akuzuarin Sh.G, të cilin e telefonon, fakt i vërtetuar nga pamjet e kamerave në fjalë e i cili u bashkëngjitet në ora 18:59:30 dhe aty rrinë deri në orën 19:05:40, rrethanë e pamohuar dhe nga mbrojtja e të akuzuarit Sh...

Se i akuzuari V.. kishte kërkuar nga i akuzuari Sh..., ti gjente një veturë, për të shkuar në Mitrovicë për të drekuar dhe pirë kafe, pasi veturën e vet e kishte me tabela të Shqipërisë dhe nuk mund ta ngiste, vërtetojnë të dy këta të akuzuar.

Se veturën e tipit “Golf IV” e kishte siguruar i akuzuari, Sh.G, është vërtetuar nga vet mbrojtja e tij, e pamohuar dhe nga i akuzuari V.M, e cila ishte marr rentë nga kushëriri i të akuzuarit Sh..., me emrin M.G.

Se nga lokali “Te Oki”, pasi sigurohet vetura, ngritën fillimisht i akuzuari V.. së bashku me shokun e tij, vërtetojnë pamjet e kamerave, siç dhe vërtetohet nga këto pamje se i akuzuari Sh.. shkon disa minuta më vonë, rrethanë e vërtetuar dhe nga mbrojtja e këtyre të akuzuarve.

Sa i përket veprimeve tjera të të akuzuarve, të cilat nuk u mbuluan nga pamjet e kamerave tek lokali në fjalë, që ka të bëjë me shkuarjen e të akuzuarit V.. me shokun e tij E..., deri tek

ambulanca për të marr një çantë E., të cilën tha se E.. e kishte lënë brenda objektit, por para derës së ambulancës dhe se të njëjtën e kishte vendosur në veturën “Jaguar” me të cilën veturë, së bashku shkojnë deri tek autolarja për të marr veturë “ Golf IV”, dhe me të arritur E..i, sipas të akuzuarit V.., ai merr çantën nga vetura “Jaguar” dhe e vendos në veturën “Golf IV”, dhe me veturë “Jaguar largohet nga aty, derisa i akuzuari V.., i cili paraprakisht e kishte marr çelësin e veturës “Golf IV” tek pronari i rentës, pasi vetura ishte në autolarje, mbetet për disa minuta pranë kësaj veture për ta pritur të akuzuarin Sh.., i cili pasi arrin , hyn në veturë të cilën e drejton vet, dhe së bashku me V..in nisen në drejtim të Mitrovicës, ku ky i fundit nuk i tregon se në bagazh të veturës E..i e kishte vendos një çantë, siç dhe nuk i tregon se pse E.. ishte larguar apo me çfarë veture ishte larguar, gjykata me te drejt ka ardhur në përfundim se këto rrethana i pohoj vet i akuzuari V.., dhe se i akuzuari V.. ishte në dijeni të ekzistimit të çantës, e cila më pas u gjet nga zyrtarët policorë në momentin kur ata ishin ndaluar në lagjen e boshnjakëve për ta pritur E..

Prandaj, bazuar në pamjet e kamerave, raportin e këqyrjes së vendit të ngjarjes, pjesërisht dhe nga mbrojtja e të akuzuarit Sh.G, lidhur me lëvizjet e tyre nga momenti i takimit e deri tek momenti kur dhe janë arrestuar, mbrojtja e të akuzuarit V.., faktin se në bagazhin e veturës “Golf IV”, u gjet çanta me substanca narkotike, kolegji pajtohet me gjetjet e gjykates se shkallës së parë se i akuzuari V.M, ishte në dijeni të ekzistimit të çantës. Kjo sepse i akuzuari V.. në mbrojtje të tij, ka deklaruar se çanta u mor në objektin e ambulancës ku punonte, u vendos në veturën “Jaguar” dhe nga aty u mor dhe u vendos në bagazh të veturës ”Golf IV”, edhe pse mohon të ketë ditur se brenda çantës ka substancë narkotike, e që një rrethanë e tillë është ikje nga përgjegjësia penale, sepse të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me lëvizjen e çantës, i’a ka lënë personit që ishte me të, të paidentifikuar si E.Sh, e aq më tepër kur ky i akuzuar në deklaratën e tij dhënë në prokurori, në tërësi ka mohuar faktin e të qenit në dijeni për çantën në fjalë, duke mos e përmend fare edhe veturën e tij të tipit “Jaguar” me të cilin deklarim është ballafaquar në shqyrtim gjyqësor, ku sipas tij e vërteta ishte ajo që ka thënë në shqyrtim gjyqësor, pra se ishte në dijeni për çantën në të cilën u gjet substanca.

Nga këto rrethana e bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar nga gjykata shkallës së parë, vërtetohën veprimet inkriminuese të akuzuarit V.M lidhur me veprën penale për të cilën është shpall fajtor, sepse i akuzuari V.., ishte në dijeni të lëvizjes së çantës, deri tek vendosja e saj në bagazhin e veturës “Golf IV”, fshehja e kësaj rrethane nga i akuzuari Sh.., sigurimi i automjetit, veprime të cilat plotësojnë elementin subjektiv të veprës penale-dashjen, andaj dhe pretendimet ankimore te mbrojtësit të akuzuarit se V..i nuk ishte në dijeni për substancën narkotike, për kolegjin janë të pa bazuara.

Kolegji gjen të pa bazuara pretendimet e prokurorisë në ankesë se i akuzuari V.M ka kryer veprë penale nga neni 273 par 2, lidhur me nenin 281 par1 pika 1.1 dhe 1.9, lidhur me nenin 31 të KPRK-së, e jo veprë penale nga neni 273 par.1 të KPRK-së. Kolegji pajtohet me gjetjet e gjykatës së shkallës së parë se nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyësor nuk është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit V.M janë plotësuar elementet e veprës penale nga neni 273 par 2 të KPRK-së, sepse për t'u kryer kjo veprë penale nevojitet të vërtetohet përveç dashjes dhe forma e kryerjes së kësaj veprë penale, pra të vërtetohet se substancën narkotike e ka blerë, transportuar, dorëzuar, ndërmjetësuar, dërguar ose e ka dërguar transit me qëllim të shpërndarjes, shitjes, ose ofrimit për shitje, e që në rastin konkret, përveç provave materiale, të cituara me lartë e të administruara në shqyrtim gjyqësor, dhe mbrojtjes së të akuzuarve, prokuroria nuk ka ofruar asnjë provë të vetme që do të vërtetonte ndonjëherë nga këto forma të paragrafit 2 të nenit 273 të KPRK-së.

*Elementet e veprës penale nga neni 273 par. 2 lidhur me nenin 281 par1 pika 1.1 dhe 1.9 lidhur me nenin 31 të KPRK-së*

Format e kryerjes së veprës penale, Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 273 paragrafi 1 të KPRK-së, e cila dispozitë ka përcaktuar se: *“Kushdo që pa autorizim blen ose posedon me qëllim të shitjes apo shpërndarjes, ose ofron për shitje substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, substanca psikotrope apo substanca analoge, dënohet me gjobë dhe me burgim prej dy (2) deri në tetë (8) vjet”,* ndërsa paragrafi 2 i nenit të lartcekur, ka përcaktuar se: *“Kushdo që pa autorizim shpërndan, shet, transporton, dorëzon, ndërmjetëson, dërgon ose dërgon në transit substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, substanca psikotrope ose substanca analoge, me qëllim të shpërndarjes, shitjes ose ofrimit për shitje, dënohet me gjobë dhe me burgim prej dy (2) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.*

Gjykata po ashtu ka analizuar dhe nenin 281 par.1, pika 1.1 dhe 1.9 të KPRK-së, e cila dispozitë ligjore ka të bëjë për raste të rënda të veprave penale nga kapitulli XXIII, e që ka përcaktuar *“Nëse vepra penale nga nenet 273, 274, 275, 276, ose 278 kryhet në më shumë rrethana si në vijim, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej 3 deri në 15 vjet”.*

Prokuroria pretendon se të akuzuarit veprën penale nga neni 273 par. 2 e kanë kryer nën rrethanën e nenit 281 par 1 pika 1.1 dhe 1.9 të KPRK-së.

Pika 1.1 e nenit në fjalë përcakton *“ kryesi vepron si anëtar i grupit”*

Pika 1.9 i nenit në fjalë përcakton *“vepra penale përfshinë sasi të mëdha të narkotikeve, substancave psikotrope ose analoge .*

Gjykata shkallës së parë po ashtu ka analizuar format e bashkëpunimit në kryerjen e veprës penale, përkatësisht nenin 31 të KPRK-së, me të cilën dispozitë është përcaktuar se: *“Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thellësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për veprë penale”*

Referuar elementeve të veprës penale nga neni 273 par. 1 të KPRK-së, për të cilën i akuzuari V.M është gjetur fajtor, për dallim nga pretendimet e prokurorisë se ka kryer veprë penale nga neni 273 par. 2, lidhur me nenin 281 par. 1, pika 1.1 dhe 1.9, lidhur me nenin 31 të KPRK-së, kjo Gjykatë pajtohet me arsyetimin e gjyqates se shkallës së parë si në vijim:

Nga provat e administruara nuk është gjetur se janë plotësuar elementet e veprës penale nga neni 273 par. 2 të KPRK-së, sepse për t’u kryer kjo veprë penale nevojitet të vërtetohet përveç dashjes dhe forma e kryerjes së kësaj veprë penale, pra të vërtetohet se substancën narkotike e ka blerë, transportuar, dorëzuar, ndërmjetësuar, dërguar ose e ka dërguar transit me qëllim të shpërndarjes, shitjes, ose ofrimit për shitje, e që në rastin konkret, përveç provave materiale, të cilat u cekën më lartë, dhe mbrojtjes së të akuzuarve, Prokuroria nuk ka ofruar asnjë provë të vetme që do të vërtetonte ndonjëherë nga këto forma të paragrafit 2 të nenit 273 të KPRK-së.

Kolegji gjen të pa bazuar pretendimet e Prokurorisë në ankesë se vepra është kryer në bashkryerje me të akuzuarit Sh.. dhe A., duke i ndërlidh veprimet e bashkryerjes në marrëveshje të tyre, por një rrethanë e tillë nuk është vërtetuar, kjo sepse me asnjë provë të vetme nuk është vërtetuar se këta të akuzuar kishin marrëveshje mes veti, përkatësisht nuk ishte kontestuese se i akuzuari V.. dhe Sh.. kishin qenë bashkë në ditën kritike, por një rrethanë e tillë në mungesë të fakteve nuk mund ti atribuohet vetvetiu një marrëveshjeje të supozuar, e aq më tepër kur vet i akuzuari V.., në mbrojtjen e tij ka deklaruar se i akuzuari Sh.. nuk ka qenë në dijeni fare për çantën e cila u gjet në bagazh të veturës “Golf IV”, derisa të akuzuarin A., asnjëri prej tyre nuk e njihnte, siç dhe nuk rezultojë me asnjë provë tjetër që do të vërtetonte lidhjen mes tyre, derisa pretendimi se veprën e ka kryer në bashkryerje me personin E.., për të cilin gjykata nuk gjeti prova se ishte identifikuar apo se kishte ndonjë hetim të hapur, për gjykatën deklarimi i të akuzuarit se të gjitha veprimet i ndërmori personi në fjalë, mbeti si provë e vetme, andaj dhe nuk vërtetohet se ishte vërtetë veprim i përbashkët i tyre, të vetmin fakt që e vërtetohet kjo gjykatë ishte sa i akuzuari V.. ishte në dijeni se çanta ka qenë në bagazhin e veturës “Golf IV”, në të cilën ishte bashk me Sh..in,

gjatë rrugëtimit nga Skenderaj deri në Mitrovicë, ku dhe u arrestua, në të cilën veturë u gjet narkotiku, e i cili u posedua pa autorizim, nga i akuzuari V.. me qëllim të shpërndarjes, rrethanë kjo e vërtetuar nga gjendja faktike si më lartë, bazuar në lëvizjet e bëra të të akuzuarit V., të cilat veprime korrespondojnë me elementet e veprës penale nga neni 273 par 1 të KPPRK-së, e ri cilësuar më të drejtë nga gjykata shkallës së parë.

Kolegji po ashtu pajtohet edhe me konstatimet e gjykates se shkallës së parë se në rastin konkret nuk rezulton se kemi të bëjmë me ndërlidhje të kësaj vepre penale me nenin 281 par. 1, pika 1.1 dhe 1.9 të KPRK-së, edhe përkundër se bashkëkryerja dhe grupi njëkohësisht nuk mund të qëndrojnë, megjithatë pika 1.1 e nenit në fjalë e cila përcakton “*kryesi vepron si anëtar i grupit*” bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar, nuk ka rezultuar se i akuzuari V.M ka vepruar si anëtarë i ndonjë grupi, derisa lidhur me pikën 1.9 të nenit në fjalë, e cila përcakton se kryerja e veprave penale nga ky kapitull është e kualifikuar dhe parasheh dënim më të lartë nëse “*vepra penale përfshinë sasi të mëdha të narkotikeve, substancave psikotrope ose analoge*”, e që në rastin konkret sasia e gjetur e substancës narkotike, prej 8606 gram, nuk mund të konsiderohet sasi e madhe e narkotikut.

Kolegji vëren se nga raporti i ekspertizës e AKF-së, me nr. të referencës AKF/2017 – 2483/2017-2239, dt. 31.10.2017, është vërtetuar se substanca narkotike e gjetur në bagazhin e veturës “*Golf IV*”, pas ekzaminimit ka rezultuar se është Kanabis (Marihuanë) që përmban Tetrahidrokanabinol, në peshë prej 8606 gram.

Kolegji rikujton se Udhëzuesi i përgjithshëm për matjen e dënimit, Nëntor – 2024, i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, në faqen 208, në *Tabelën C: Substancat narkotike më të përdorura*, për t’ua bërë më të lehtë gjykatave të kuptojnë se sa një substancë narkotike orientimisht dhe për qëllime krahasimi do mund të kualifikohej si *sasi e vogël* apo *sasi e madhe*, për Kanabisin si sasi e madhe ka parapa peshën 10.0 kg, e që në rastin konkret sasia e Kanabisit e gjetur në bagazhin e veturës “*Golf IV*”, përmban peshë me të vogël se 10.0 kg, andaj edhe nuk mund të konsiderohet si sasi e madhe.

Në raport me veprën penale, Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, i akuzuari V.M ka pranuar fajesinë në seancën e shqyrtimit fillestar, pranim i cili është aprovuar nga gjykata shkallës së parë.

Kolegji gjen të pa bazuar pretendimin e mbrojtësit të akuzuarit V.M se për veprën penale, Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim dhe shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374

par. 1 të KPRK-së, është aplikuar ligji me i pa favorshem duke kerkuar që të aplikohet ligji me i favorshem e që mbrojtja nuk ka përcaktuar se cili Kod Penal është më i favorshëm.

Kolegji gjen se në kohën e kryerjes se vepres penale, Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim dhe shfrytëzim të paautorizuar të arm nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, e që është data 13.07.2017, ka qenë në fuçi, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr.04/L-82, i cili për këtë vepër penale, ka parapare dënim me gjobë deri në 7500 € ose me burgim deri në pesë vite. Ndërsa në kohën kur i akuzuari është gjykuar ka qenë në fuçi Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr.06/L-074, i cili për vepër penale, Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim dhe shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, ka parapare dënim me gjobë deri në 7500 € ose me burgim deri në pesë vite, e që do të thotë se të dy Kodet kanë parapare ndeshkueshmerinë e njëjtë për këte vepër penale.

#### Të gjeturat për vendimin mbi dënimin

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit vlerëson se pretendimet ankimore të prokurorit për dënim më të ashpër, ndërsa të mbrojtësit të akuzuarit për dënim me të butë, nuk janë të bazuara.

Gjykata e shkallës së parë më rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin V.M ka pas parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese të parapara me nenin 73 dhe 74 të KPRK-së, të cilat janë me ndikim me rastin e marrjes së vendimit. Gjykata si rrethana lehtësuese për veprën penale nga neni 273 par. 1 të KPRK-së, për të akuzuarin gjeti se nga koha e kryerjes së veprës penale kanë kaluar më shumë se 7 vite dhe se pa fajin e të akuzuarit kjo çështje penale është prolonguar nën rrethanat e njohura për Gjykatën e Mitrovicës, rrethanat personale të tij, është stomatolog me profesion, familjar, ndërsa si rrethana rënduese për veprën penale nga neni 273 par. 1 të KPRK-së, ka gjetur shkallën e lartë të përgjegjësisë penale, e që i akuzuari veprën penale e ka kryer me dashje direkte dhe paramendim, për shkak se ishte involvuar në sigurimin automjetit në të cilin u gjet substanca narkotike. Motivi i kryerjes së veprës penale me qëllim të përfitimit pasuror në mënyrë të kundërligjshme si dhe intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur, përkatësisht shëndetin e të rinjve nga substancat narkotike të shpallura edhe me ligj si të rrezikshme për shëndetin e njeriut. Intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur të shoqërisë, veprat penale të kësaj natyre me substanca narkotike, gjithnjë e më shumë janë trend i rritjes së këtyre veprave penale në shoqëri, duke cenuar vlerat e mbrojtura shoqërore, jetën dhe shëndetin e qytetarëve, e posaçërisht ku përdorues të narkotikut janë të rinjtë si vlerë e rëndësishme e shoqërisë, andaj dhe mbi bazën e



këtyre rrethanave rënduese i'u shqiptua dënimi me gjobë, si në dispozitiv të aktgjykimit. Si rrethanë rënduese tjetër, gjykata, mori për bazë dhe faktin se i akuzuari më parë ishte dënuar me tri aktgjykime të formës së prerë në vitin 2006, dënim me gjobë për veprë penale falsifikim i dokumentit nga neni 332 të KPK, në vitin 2021, dënim me gjobë për veprë penale vjedhje në shërbime nga neni 314 të KPRK-së, dhe në vitin 2022, dënim me gjobë, për veprë penale, mbajtje në pronësi kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par 1 i KPRK-së.

Gjykata duke vlerësuar rrethanat e lartpërmendura në raport me të akuzuarin V., ka aplikuar dispozitat për zbutje të dënimit, duke i shqiptuar dënim nën kufirin e paraparë ligjor, në kuptim të nenit 76 (kufijtë e zbutjes së dënimeve) par. 1, nën par 1.4 të KPRK-së, në të cilën dispozitë, është përcaktuar se: “Kur ekzistojnë kushtet për zbutjen e dënimit nga neni 74 i këtij Kodi, gjykata mund të zbusë dënimin brenda kufijve në vijim: 1.4. nëse për veprën penale është paraparë si masë më e ulët dënimi me burgim prej dy (2) vjet, dënimi mund të zbutet deri në gjashtë (6) muaj burgim”, në rastin konkret kjo dispozitë ligjore është aplikuar në raport me veprën penale nga neni 273 par. 1 të KPRK-së, për të cilën parashihet dënim me gjobë dhe burgim nga 2 deri në 8 vite, përkatësisht ka zbut dënimin me burgim, derisa është vlerësuar se dënimi me gjobë si dënim unik për të dy veprat penale për të cilat u shpall fajtorë, është vlerësuar se është adekuat e në përputhje me rrethanat lehtësuese dhe rënduese për të akuzuarin, të cilat ndikuan në matje të dënimit. Andaj, gjykata duke i marrë për bazë të gjitha rrethanat e lartcekura, ka ardhur në përfundim që të akuzuarit ti shqiptojë dënim si në pikën I. të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar, i cili dënim është ligjor, adekuat, i drejtë, në harmoni me peshën e veprave penale, shkallën rrezikshmërisë shoqërore dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit, me të cilat dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit i paraparë nga neni 41 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarve në kryerjen e veprave penale në të ardhmën, të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprat penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Një vlerësim të tillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo Gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa rrethanat e pretenduara rënduese në ankesën e Prokurorit si: pesha e veprave penale, rrezikshmëria shoqërore e veprave penale, janë pretendime të përgjithësuara, të cilat nuk e justifikojnë shqiptimin e një dënimi me të ashpër. Disa nga rrethanat në të cilat thirret mbrojtës i të akuzuarit dhe atë: se dënimi i shqiptuar është i ashpër, veçanerisht ai me gjobë, gjendja ekonomike e të

akuzaurit dhe familjes se tij, kolegji gjen se keto rrethana kanë qenë objekt vlerësimi nga gjykata e shkallës së parë, kurse të tjerat edhe pse nuk kanë qenë objekt vlerësimi nuk janë të asaj natyre që justifikojnë zbutjen e dënimit kur merret parasyshë pesha e veprave penale, andaj të gjitha këto rrethana sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj Gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Prandaj, kjo Gjykatë vlerëson se dënimet e shqiptuara ndaj të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë janë në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprave të kryera penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si ekzekutor, dhe me intensitetin e rrezikimit apo pasojave të shkaktuara dhe se me to do të mund të parandalohet i akuzuari nga kryerja e veprave penale në të ardhmën, si dhe do të parandalohen personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Kolegji gjen të pa bazuara pretendimet ankimor të mbrojtësit të akuzuarit V.M, se vendimi mbi konfiskimin e mjeteve në vlerë prej 2115 €, të gjetura në ditën kritike tek i akuzuari i cili i kishte me vete nga se ishte në përfundim të punës, se këto mjete janë pjesë e punës në ordinancën private ku punonte, se me asnjë provë nuk janë vërtetuar se janë pasuri e fituar me vepër penale.

Kolegji gjen se gjykata shkallës së parë duke u bazuar në provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor me të drejtë ka vërtetuar se janë plotësuar kushtet ligjore për konfiskimin e parave në shumë prej 2115 euro, të gjetura tek i akuzuari V.M, si pasuri e fituar me vepër penale, edhe përkundër faktit se i akuzuari kishte deklaruar se këto para ishin nga puna e tij si stomatolog, por nga ana e tij dhe mbrojtjës nuk është ofruar ndonjë provë për të vërtetuar një fakt të tillë.

#### *Pretendimet ankimore të Prokurorisë sa i përket pjesës liruese të aktgjykimit*

Kolegji gjen të pa bazuara pretendimet e Prokurorisë në ankesë se gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe si pasojë e kësaj është shkelur edhe ligji penal në dobi të akuzuarve, se gjykata ka dështuar të sqarojë se pse në rastin konkret kemi të bejmë me vepër penale nga neni 273 par. 1 e jo nga neni 273 par. 2, lidhur me nenin 181 par. 1 pika 1.1 dhe 1.9 të KPRK-së, pasi që të akuzuarit ditën kritike, janë zënë në veturën e përshkruar si në dispozitiv të aktakuzës.

Kolegji vëren se nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor nga gjykata shkallës së parë, dhe atë nga raporti i ekspertizës e AKF-së, me nr. të referencës AKF/2017 – 2483/2017-2239 dt.

31.10.2017, është vërtetuar se substanca narkotike e gjetur në bagazhin e veturës “Golf IV”, pas ekzaminimit ka rezultuar se është prezentë Kanabis (Marihuanë) që përmban Tetrahidrokanabinol, në peshë prej 8606 gram, rrethanë e paraqitur në foto dokumentacion të vendit të ngjarjes, mirëpo me asnjë provë të vetme nuk është vërtetuar marrëveshja e të akuzuarit Sh.Gdhe A.Gme të akuzuarin V.M, përkatësisht me asnjë provë nuk është vërtetuar se këta dy të akuzuar ishin në dijeni të ekzistimit të substancës narkotike.

Prokuroria pretendon se kishte marrëveshje mes të akuzuarve, Sh.G, V.M dhe shtetasit të Shqipërisë, E.Sh, sepse ata u takuan ditën kritike në ish kafiterinë “Time Caffè” tani “Te Oki”, në Skenderaj, mirëpo përveç vërtetimit të rrethanës se ata ishin takuar, fakt i pamohuar nga i akuzuari Sh., nuk është vërtetuar se a kishte marrëveshje mes tyre, kjo për arsye se edhe i akuzuari V., në mbrojtje të tij në asnjë moment nuk ka deklaruar se i akuzuari Sh.. kishte qenë në dijeni për çantën e vendosur në bagazh të veturës “Golfi IV”, siç edhe nuk ishte në dijeni për arsyet e marrjes së kësaj veture, sepse i akuzuari V.. i’a kishte kërkuar t’a siguronte nën arsyetim se nuk mund t’a ngiste veturën e tij të tipit Jaguar, e cila kishte tabela të Shqipërisë, siç deklaroi edhe vet i akuzuari Sh...

Prokuroria pretendon se kontaktet telefonike mes të akuzuarit Sh.. dhe personit me emrin E., kalimi i kufirit Kosovë-si dhe pamjet nga kamerat, vërtetojnë se i akuzuari Sh., kishte marrëveshje me të akuzuarit, përkatësisht se ishte në dijeni të ekzistimit të substancës narkotike sepse po përcilleshin nga vetura Jaguar, drejtuar nga personi me emrin E.. dhe vetura “Golf II”, drejtuar nga i akuzuari A.G, mirëpo këto pretendime për kolegjin janë të pa bazuar, sepse kontakti telefonik, edhe pse u mohua nga i akuzuari Sh., të ketë pas ndonjëherë kontakt me personin E., fakt i provuar dhe nga i akuzuari V., të cilët thanë se ka pas mundësi të kontaktohet Sh..i prej V..it, nga numri i E..it, nga të cilat kontakte, të bëra disa ditë para ngjarjes kritike, në asnjë mënyrë dhe me asnjë provë nuk është vërtetuar se çka në fakt ishte biseduar, apo kush me kë kishte biseduar, derisa nga pamjet e kamerave, nuk ishte kontestuese se vërtetuan lëvizjet me vetura, por se a ishte në dijeni i akuzuari Sh.. për arsyen e përcjelljes, kjo nuk është vërtetuar me asnjë provë të vetme, siç dhe nuk është vërtetuar as ndërlidhja e të akuzuarit A.. me të akuzuarit tjerë, kjo sepse përveç pamjes së paraqitur nga kamerat, të lëvizjes së veturës “Golf II”, të cilën nuk e mohoj i akuzuari A.. se ishte e tij, dhe se atë ditë ka pas mundësi të jetë në atë pjesë të Mitrovicës, pasi ishte tregtar, por mohoj se kishte të bëjë me substancën narkotike të gjetur, apo se atë ditë të ishte në dijeni se pasagjer ka pasur personin me emrin E., dhe se të akuzuarit kurrë nuk i kishte njohur apo takuar ndonjëherë.

Kolegji pajtohet me perfundimin e gjykatës së shkallës së parë se referuar gjendjes faktike të vërtetuar si më lartë, bazuar dhe në mbrojtjen e të akuzuarve, se pirja e kafesë gjatë takimit mes Sh.. G, V.M dhe personit me emrin E.Sh-Eri, në kafiterinë “Time Caffè”, tani “Te Oki” në Skenderaj, nuk vërteton marrëveshjen për transport me qëllim shitje të substancës narkotike, të gjetur ditën kritike. Gjykata nuk mund të mbështet aktgjykimin në supozime, se ata kishin një marrëveshje, për faktin se atë ditë u takuan, u sigurua vetura dhe së bashku u nisën në drejtim të Mitrovicës, kjo sepse vet i akuzuari V.. ka deklaruar se i akuzuari Sh.. nuk ishte në dijëni të çantës, pra as ku u mor, kush e vendosi në Jaguar, kush e nxori nga kjo veturë dhe e vendosi më pas në veturën “Golf IV”, se nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari Sh.. Gecaj, ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Në raport me të akuzuarin A., Prokuroria nuk ka dhënë shpjegim se cilat prova mbështesin pretendimin e saj për këtë të akuzuar, e që përveç provës materiale që ka të bëjë me lëvizje me veturën e tipit “Golf II”, Prokuroria nuk ka ofruar prova tjera, lëvizje të cilën e ndërlidhi me marrëveshje me të akuzuarit, por kjo ka mbetur si provë e vetme e pambuluar me prova tjera.

Se nga “ETC” ka dal vetura Golf IV, dhe është nis në drejtim të lagjes së Boshnjakëve, është vërtetuar nga sekuencat e siguruara nga kamerat e vendosura tek udhëkryqi i rrugës “Oslobogjenje”, dhe “Knjaz Milosh”, pamje nga kamera 3, ku fillimisht vërehet veturë e tipit “Golf 2”, e të akuzuarit A.G, ora 19:29:00, e cila kthen djathtas dhe vazhdon në rrugën “Oslobogjenje”, e cila kalon veturën “Golf IV”, kjo e fundit pasi hyn në thellësi të rrugës në fjalë, aty ndalon, (vendi ku janë arrestuar nga policia), rrethanë e cila nga i akuzuari V.., nuk është kontestuar, pasi ai i kishte thënë të akuzuarit Sh.., të ndalojnë aty për ta marr personin me emrin E.., derisa i akuzuari A.., nuk ka mohuar se ishte vetura e tij, por nuk i është kujtuar se me kë ka qenë pasi ai shpeshherë ka marrë udhëtar tek ura, që e lidhë Veriun dhe Jugun në Mitrovicë.

Në referim të provave materiale, mbrojtjes së të akuzuarit Sh.. dhe të akuzuarit A.., gjykata shkallës së parë me të drejtë ka ardhur në përfundim se sekuencat e marra nga kamerat e lartcekura janë të besueshme, të cilat vërtetuan lëvizjet me vetura të të akuzuarve duke pasur parasysh se këto lëvizje nuk u mohuan nga të akuzuarit, përkatësisht i akuzuari Sh.., tha se ishte në veturën Golf IV, me të akuzuarin V.., derisa i akuzuari A.. ishte me veturën të tij të tipit Golf 2, por se kush ishte me te, kjo ka mbetur e pa vërtetuar me prova tjera, siç dhe nuk është vërtetuar nga këto pamje të kamerave se kush e ngiste veturën e tipit “Jaguar”, apo kush ishte personi që ishte në atë veturë dhe se a kishte marrëveshje mes këtyre personave.

Pra, përfundimisht kolegji pajtohet me përfundimin e gjykatës së shkallës së parë se nga të gjitha provat e administruara personale dhe materiale nuk është arritur të vërtetohet se të akuzuarit Sh.G dhe A.G, kanë kryer veprën penale, Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 273 par. 2, lidhur me nenin 281 par. 1 pika 1.1 e 1.9, e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, pasi që me asnjë provë të administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk është provuar se të akuzuarit pa autorizim kanë transportuar substancën narkotike-marihuanë të shpallur me Ligj si narkotik, me qëllim të shitjes, siç pretendon prokuroria dhe rrjedhimisht edhe kryerjes së veprës penale. Duke analizuar pretendimet e prokurorisë dhe duke i ndërlidhur me provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor nga gjykata shkallës së parë, kolegji gjen se në veprimet e të akuzuarve Sh.G dhe A.G, nuk përmbushën elementet e veprës penale për të cilën të njëjtit janë akuzuar.

Andaj, mbi bazën e vërtetimit të gjendjes faktike, gjykata e shkallës së parë drejtë ka aplikuar edhe ligjin penal kur të akuzuarit Sh.G dhe A.Gi ka liruar nga akuza për shkak se nuk është vërtetuar se të njëjti kanë kryer, veprën penale, sim ë lartë, pasi që qartazi nga provat e administruara nuk kanë rezultuar si të provuara tiparet e veprës penale të cituar me lartë dhe as që kanë qenë të përshkruara veprimet inkriminuese në dispozitiv të akuzës që do të përbënin figurën e veprës penale për të cilën të njëjtit janë akuzuar, andaj, për rrjedhojë nuk ka mundur të ketë alternativë tjetër të aplikimit të ligjit penal.

Nga arsyet e sipër cekura dhe në bazë të nenit 401 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për Krime të Rënda

PAKR.nr.488/2024, datë 29.10.2024

B. Profesionale

Anëtarët e kolegjit

Kryetari i kolegjit

Fitore Batatina

Afërdita Bytyçi

Bashkim Hyseni

Zyhdi Haziri